



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 662/6 Prot.

Tiranë, më 09.12.2021

V E N D I M

Nr.153, Datë 09.12.2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 67, datë 10.06.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Administrimi i shërbimit civil në subjektin e mbikëqyrur, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku është

parashikuar në mënyrë të shprehur se, “fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”.

Objekti i mbikëqyrjes është i fokusuar tek veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë aplikimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të karrierës, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 662/1 prot., datë 10.06.2021, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 662/2 prot., datë 10.06.2021, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 662/4, prot., datë 28.10.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 5 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i punës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, përgjatë gjithë periudhës së kontrolluar, Komisioneri ka evidentuar disa aspekte problematike të zbatimit të ligjit, të cilat po i paraqesim në vijim:

- Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, ka pasur probleme gjatë përgatitjes së planit të nevojave për rekrutim, pasi nuk ka reflektuar në këtë akt, pozicionet e lira të krijuara gjatë vitit.
- Nuk është përcaktuar numri i pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar kriterin ligjor, që është kufiri prej 20%, i numrit total të vendeve të lira për çdo vit kalendarik.

Në lidhje me këtë konstatim, njësia përgjegjëse, duhet të tregojë kujdes që në të ardhmen, në hartimin e planit të nevojave për rekrutim, të reflektojë qartë mangësitë e konstatuara nga Komisioneri dhe ta hartojë këtë akt, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”. Ky është një rast që do të ndiqet në vazhdimësi në të ardhmen nga Komisioneri dhe institucioni duhet të

informojë Komisionerin, duke i dërguar një kopje të aktit, në momentin e miratimit të tij për vitin në vijim.

- Procedurat e rekrutimit për të gjitha pozicionet e nivelit ekzekutiv, nga njësia përgjegjëse, janë realizuar me konkurrime individuale dhe jo konkurrim në grup pozicionesh, si dhe numri i kandidatëve që kanë aplikuar në shumicën e konkurrimeve ka qenë i ulët (1 (një) konkurrent, i cili edhe ka fituar).

Ky është një aspekt i rëndësishëm i administrimit të procesit të rekrutimit, pasi vë në diskutim zbatimin e parimeve të këtij procesi që janë merita dhe profesionalizmi, të cilat sigurojnë një proces përzgjedhës në drejtim të kandidatëve cilësorë. Konkurrimi për një pozicion të vetëm dhe numri i ulët i kandidatëve në proces, bëjnë objektivisht të pa mundur respektimin e parimeve, megjithëse zbatimi formal i procedurave të konkurrimit, të krijon përshtypjen e një procesi të rregullt ligjor.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse e institucionit, në të ardhmen duhet të kujdeset që për pozicionet e nivelit ekzekutiv, të realizojë procedura konkurrimi sipas grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë, për të tërhequr sa më shumë kandidatë cilësorë në shërbimin civil.

- Njësia përgjegjëse, në raste të veçanta, duke mos kuptuar drejt ligjin, ka realizuar procedurë ngritje në detyrë duke iu referuar vetëm kategorizimit të pagës dhe jo kategorizimit të niveleve të nëpunësisë civile, sipas nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në këto rrethana, Komisioneri sjell në vëmendjen e njësisë përgjegjëse se, në të ardhmen, në rastet e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duhet të vlerësohet njëkohësisht të dy elementet që janë: **a)** kategoria e nëpunësisë civile sipas parashikimeve të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil (*niveli i ulët, i mesëm, i lartë dhe ekzekutiv*) dhe **b)** kategoria e pagës, me qëllim që të plotësohet kërkesa ligjore sipas nenit 26, pika 3/b, ku përcaktohet se, *për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, mund të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.*

- Rezulton që lista e pritjes së fituesve, gjatë periudhës 2- vjeçare të vlefshmërisë së saj, në të gjitha rastet, nuk ka funksionuar.

Njësia përgjegjëse e institucionit, në të ardhmen, duhet të administrojë drejtë dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil listën e fituesve. Për plotësimin e pozicioneve të lira të krijuara, brenda periudhës 2- vjeçare të vlefshmërisë së saj, fillimisht vendi i punës duhet ti ofrohet këtyre kandidatëve atje ku ata plotësojnë kërkesat e veçanta dhe më pas, nëse nuk bëhet e mundur

plotësimi sipas listës, të vazhdojë me procedurat konkurruese. Lista e konkurruesve fitues duhet të përditësohet pas çdo konkurrimi.

→ Për punonjësit në periudhë prove, në disa raste konstatohet se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër nën kujdesin e të cilit duhet të jetë kjo kategori punonjësish dhe për pasojë mungon edhe vlerësimi me shkrim në dosjet e tyre.

Në lidhje me këtë aspekt, në të ardhmen, njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset që eprori direkt i nëpunësit, të caktojë punonjësin që do të mbikëqyrë nëpunësin në periudhë prove dhe para se të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit, krahas vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës dhe certifikatës së trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s, duhet të administrojë edhe mendimin e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi civil në periudhë prove.

Sa parashtruam më sipër, paraqesin disa elementë paligjshmërie që janë konstatuar nga mbikëqyrja në këtë institucion, të cilat nisur nga natyra e tyre, në disa raste nuk cenojnë thelbin e proceseve të realizuara dhe në raste të tjera gabimet janë korrigjuar nga vet institucioni.

Parregullsitë janë pasqyruar në raport, me qëllim që të sillen në vëmendjen e subjekteve që kanë detyrë të administrojnë shërbimin civil dhe të mos përsëriten në të ardhmen, e ndërkohë do të jenë në fokusin e kontrollit të Komisionerit në vazhdimësi, për të mos lejuar përsëritjen e tyre.

Subjekti i mbikëqyrur, është njohur me projekt raportin nëpërmjet shkresës nr. 894/3 prot., datë 08.11.2021 dhe e ka dërguar pranë Komisionerit të nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se parregullsitë e konstatuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme. Vërejtjet e pasqyruara në këtë akt, janë të karakterit parimor që nuk e cenojnë në thelb ndonjë prej proceseve të evidentuara, e në këto kushte, procesi i mbikëqyrjes nuk do të shoqërohet me vendim paralajmërimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i

Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Problematikat e evidentuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa vendim paralajmërues. Sqarimi me burimet njerëzore e më tej ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen rishtas, do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të stafit të Komisionerit.

2. Për këtë vendim të njoftohet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha